



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:052827

Datë: 27.05.2022

Numri i dokumentit: 03065504

PPP.nr.66/2019

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG, si përmbarimore e përberë nga Gjyqtari individual Blerim Istrefi, ne çështjen juridike të kreditorit K. R. M. A. SH.A Njësia Operative Istog, kundër debitorit Xh. Z. nga Fsh. S. K-Istog, lidhur me pagesën e borxhit në shumë prej 153.45€, duke vendosur sipas prapësimit te parashtruar nga ana e debitori me dt. 16.06.2019, kundër Urdhrit mbi Lejimin e Përmbarimit, jashtë seancës me datën 27.05.2022, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET PJESËRISHT prapësimi i debitorit Xh. Z. nga Fsh. S. K-Istog, ashtu që:

II.SHFUQIZOHET PJESËRISHT Urdhri mbi Lejimin e Përmbarimit P.nr.292/2019, i dt:30.04.2019, për periudhën kohore 01.07.2016 e gjerë më 31.12.2017 në shumë prej 88.80 €, dhe **OBLIGOHET** debitori Xh. Z. nga Fsh. S. K-Istog, që kreditorit K. R. M. A. SH.A Njësia Operative Istog, në emër të borxhit për bartjen e mbeturinave për periudhën kohore 31.01.2018 gjer me 31.03.2019, t'ia paguaje shumën prej 64.65 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Kreditori, kreditorit K. R. M. A. SH.A Njësia Operative Istog, ka parashtruar propozim për përmbarim kundër debitorit Xh. Z. nga Fsh. S. K-Istog, në emër të borxhit për bartjen e mbeturinave për periudhën kohore 01.07.2016 e gjer me 31.03.2019, ne shume totale prej 153.45€, të gjitha këto në afat 7 ditor në të kundërtën, të bllokohen llogaritë bankare të debitorit, e nëse nuk ka mjete

në llogari të bëhet regjistrimi, sekuestrimi, vlerësimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të pa luajtshme e mjetet e mbledhura të derdhen në llogari të kreditorit, të gjitha këto të specifikuara në propozimin për përmbarim të dt. 30.04.2019.

Përmbaruesi Privat me Urdhrin P.nr.292/2019, i dt:30.04.2019, e ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit.

Debitori Xh. Z. nga Fsh. S. K-Istog ka parashtruar prapësim me shkrim, kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimit, me kërkesë që të prishet urdhri dhe të përfundohet procedura përmbarimore me arsyetimin se dokumenti me të cilin është lejuar përmbarimi nuk është në origjinal e as kopje i vërtetuar si dhe ka arritur parashkrimi konform nenit 360 par.1 pika 1.3 dhe par.2 të LMD-së

Kreditori, ka parashtruar përgjigje në prapësim me kërkesë që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pa bazuar dhe të vërtetohet urdhri mbi lejimin e përmbarimit.

Gjykata Themelore në Pejë – Dega Istog, si përmbarimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP vlerësoi prapësimin e debitorit dhe gjeti se të njëjtit është i bazuar pjesërisht. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit pjesërisht tregojnë shkaqe sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, sipas të cilave do të pengohej përmbarimi i lejuar nga përmbaruesi privat.

Gjykata pas shikimit të shkresave tjera të lëndës, si dhe sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim kur thirret në atë se dokumenti me të cilin është lejuar përmbarimi nuk është në origjinal e as kopje i vërtetuar, të njëjtat pretendime gjykata i refuzoj si të pa bazuara pasi që fatura me të cilën është lejuar përmbarimi si dhe ekstrakti i vërtetuar nga librat afarist që i është bashkangjitur faturës, janë në origjinal dhe i plotësojnë kushtet ligjore konform nenit 29 par.1.2,3 dhe par.3, e në lidhje me nenin 37 dhe 38 të LPP-së për lejimin e përmbarimit.

Kurse sa i përket pretendimeve rreth parashkrimit konform nenit 360 të LMD-së, për të njëjtat pretendime gjykata gjeti se janë pjesërisht të bazuara, për faktin se i tërë borxhi me të cilin ngarkohet debitori Xh. Z. nga Fsh. S. K-Istog për periudhën kohore 01.07.2016 e gjerë më 31.12.2017, është borxh i parashkruar, konform nenit 360 par.1, për faktin se debitori nga transaksioni i kreditorit gjatë kësaj periudhe shihet se nuk ka bërë asnjë pagës, dhe se me vet faktin se ndërmjet kreditorit dhe debitorit nuk ka ekzistuar paraprakisht një marrëveshje për ri programim eventuale të borxhit, nuk kemi ndërprerje të rrjedhjes së afatit të parashkrimit, konform nenit 368 të LMD-se.

Sa i përket borxhit për periudhën kohore 31.01.2018 e gjerë me 31.03.2019, gjykata, gjeti se i njëjti borxh është i bazuar dhe nuk ka vjetërsim të borxhit të kreditorit, në raport me debitorin për këtë periudhë kohore, referuar nenit 360, par.2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077), parashihet

qe afati i parashkrimit për çdo kërkesë te arritur gjate një viti, fillon te rrjedhe ne fundin e atij viti, e qe ne rastin konkret për te gjitha kërkesat e arritura ne vitin 2018, afati I parashkrimit ka filluar te rrjedh me 01.01.2019, dhe ne rastin konkret nuk kemi kalim te afatit te parashkrimi, për faktin se kreditori, propozimin për përmbarim e ka parashtruar me datën 30.04.2019, me çka ka shkaktuar ndërprerjen e rrjedhjes se afatit te parashkrimit, konform nenit 369 te Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077).

Duke u bazuar në nenin 17 të LPP-së, gjykata përshtatshmërisht aplikoj dispozitat ligjore Ligjit të Marrëdhënieve te Detyrimeve.

Prandaj nga të lartcekurat, e duke u bazuar ne nenin 3, 17, 29 par.1.2, 1.3 dhe par.3, 37, 38, 69, 71, 73 par 3 të LPP-së (Ligjit për Procedure Përmbarimore), ne lidhje me nenin 360 par.1 dhe 2, 368 dhe 369 të LMD-së, gjykata vendosi si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG
PPP.nr.66/2019 dt: 27.05.2022

G J Y Q T A R I
Blerim Istrefi

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga pranimi i të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.